




| | | | |
|---|---|----------------------------------|-----------------------------------|
| Primitur / Dorezuar / Dunimero / Proceduro / Received / Delivered | 25.03.2022 | 2 | viti / god / year |
| Organ / Njësia / Organ / Jedinstvo / Org / Unit | Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No. | Shtesa / Prilog / Appendix | Sasia / Kolicina / Quantity |
| SKIMSHICK | 1614/2022 | | 1/5 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 182/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi–Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtare, Flakron Gashi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.258/20 të datës 21.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të pranuar me datë 28.02.2022, ka shqyrtuar e ankesën A.nr.653/2019, të datës 23.10.2019 e parashtrua nga ankuesja [redacted] me adresë banimi: [redacted] Komuna e Gjakovës, kundër Vendimit me numër KZKA Nr:24/2019 të datës 30.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.03.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.653/2019 e datës 23.10.2019 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

II. Shfuqizohet Vendimi me numër KZKA Nr:24/2019 i datës 30.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave si dhe **Anulohet** procedura e rekrutimit sipas konkursit të datës 08.08.2019 e shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për pozitën “*Zyrtar për Promovimin e Turizmit Kulturor*” dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me datën 02.08.2019 nga Departamenti për Administrimit e Shërbimin Civil/ Ministria e Administratës Publike, ka pranuar autorizimin për shpalljen e konkursit për pozitën “*Zyrtar për Trashëgimi*” në kuadër të Departamentit të Trashëgimisë së Kulturës, ndërsa Ministria e

Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka shpallur konkursin me datë 08.08.2019 për pozitën: “Zyrtar për Promovimin e Turizmit Kulturor” në Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Gjakovë.

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe e njëjta nuk është përfshirë në listën e ngushtë dhe nuk është ftuar t’i nënshtrohet testit me shkrim të datës 29.08.2019. E pakënaqur me mos përfshirjen në listën e ngushtë, ankuesja me datë 30.08.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave ka nxjerrë vendimin numër KZKA Nr.24/2019 të datës 30.09.2019 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses të datës 30.08.2019.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin KZKA Nr.24/2019 të datës 30.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 23.10.2019 nëpërmjet e-maili ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila është protokolluar me numër:4999/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 01.11.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa me datën 11.11.2019 dhe numër protokoli 5324/2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 27.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 21.02.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.258/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 27.11.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 23.10.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 23.10.2019 me numër protokoli 4999/2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Vendimin numër KZKA Nr.24/2019 të datës 30.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Diploma numër Nr.843 e datës 18.02.2009; Çertifikatën e notave të datës 10.01.2019; Diploma e datës 18.01.2011; Diploma e datës 113.08.2011; Diploma e datës 18.01.2012; Diploma e datës 09.07.2012; Referencë pune e datës 26.04.2018; Çertifikatën me numër protokoli:33; Referencë e datës 20.10.2011; Çertifikatën e periudhës qershor-korrik të vitit 2009; Çertifikatën e datës 18.07.2013; Çertifikatën e periudhës mars 2011; Vërtetim i datës 16.12.2009; Çertifikatën e datës 19.06.2019; E-maili i datës 23.10.2019; Kërkesa për përgjigje na ankesë e datës 01.11.2019; Përgjigja në kërkesë e datës 11.11.2019; Kërkesa për fillimin e rekrutimit (punësimit) e datës 06.08.2019; Shkresa e datës 06.08.2019 më numër 3357/2019-2; konkursi i datës 08.08.2019; Autorizimi i Departamentit për Administrimit e Shërbimin Civil të datës 02.08.2019; Vendimi për themelimin e komisionit për zgjedhës i datës 26.08.2019; Akt emërimi i datës 08.06.2018; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit të datës 18.06.2014; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 01.07.2014; Akt emërimi i datës 25.01.2012; Akt emërimi i datës 16.07.2002; Formulari form.MAP-SHCK-04 për Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Listën e ngushtë për testin me shkrim, lista e kandidatëve për intervistë me gojë; Kërkesa për punësim e kandidatës me dosjen e bashkangjitur; kërkesa për punësim e kandidatës së pranuar e datës 21.08.2019; Ekstrakti nga regjistri civil i gjendjes civile i datës

03.04.2018; Çertifikatën e datës 07.07.2015; Vërtetim i datës 18.01.2017; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore Prizren dega në Suharekë e datës 17.12.2017; referencë e datës 31.12.2014; Referencë e datës 30.07.2019; Çertifikatë e datës 29.03.2012; Çertifikatë e datës 30.12.2016; Çertifikatën 27.03.013; Kërkesa për punësim e kandidatës [redacted] me dosjen e bashkangjitur; E-mailin e datës 27.08.2019; E-mailin e datës 03.09.2019; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 06.09.2019; Formulari Form.MAP-SHCK-05 për Përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Formulari Form.MAP-SHCK-07a për Përcaktimin e kriterëve për testimin me gojë për vendimin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formulari Form.MAP-SHCK-09 për Përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formulari Form.MAP-SHCK-10 për Renditjen Përfundimtare të kandidatëve; Formulari Form.MAP-SHCK-11 për Raportin Final të rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 05.09.2019; Emaili i datës 26.11.2019; Kërkesa e datës 29.07.2019 për aprovimin për shpallje të konkursit; Aprovimi për shpalljen e konkursit i datës 02.08.2019; Testi me shkrim i kandidatës [redacted] Formularët Form.MAP-SHCKO-08a për Vlerësimet individuale të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Aplikacioni për punësim i ankueses i datës 20.08.2019; kopja e letërnjoftimit të ankueses; E-mailin e datës 09.09.2019; Testi me shkrimi i kandidatës [redacted] Diploma me numër 843 e datës 18.02.2009; Testi me shkrim i kandidatës [redacted] Njoftimin e datës 27.11.2019 me numër prot:5614; Aktgjykimin A.nr.258/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] **është e bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Promovimin e Turizmit Kulturor” është zhvilluar në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses ka shqyrtuar në tersi procedurën e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Promovimin e Turizmit” të shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve më datë 29.07.2019 ka bërë kërkesën për autorizim për shpalljen e konkursit për pozitën “Zyrtar për Trashëgimi” me përshkrimin: *“Pozita do të shpallet si Zyrtar për Promovimin e Turizmit Kulturor për shkak të mungesë së këtij titulli në katalog dhe do të vendoset në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Gjakovë, si institucion vartës i MKRS-së dhe bie në kodin 815 të listës së pagave”* tek menaxheri i Personelit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil në Ministrinë e Administratës Publike e ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 02.08.2019 dhe ka lëshuar autorizimin për publikim e konkursit me specifikacionin për pozitën “Zyrtar për Trashëgimi” në Departamentin për Trashëgimi Kulturore.

Kolegji ka gjetur se inicuesja e kërkesës për hapjen e procedurave të rekrutimit për pozitën e kontestuar në kërkesën e saj të datës 29.07.2019 ka deklaruar se pozita “Zyrtar për Promovimin e Turizmit Kulturor” për të cilën Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dëshiron ta rekrutojë mungon në katalogun e vendeve të punës, ndërsa me qëllim të plotësimit të kësaj pozite është bërë kërkesa për autorizimin e hapjes së konkursit për pozitën “Zyrtar për Trashëgimi”, ndërsa në bazë të Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës të plotësuar dhe ndryshuar me vendim të Ministrit të Ministrisë për Administratë Publike me datë 21.02.2018, Kolegji ka kontestuar se pozita “Zyrtar për Promovimin e Turizmit Kulturor” nuk ekziston, ngase nuk është pozitë e aprovuar siç përcaktohet me procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr.05/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil neni 29 paragrafi 9 dhe 10 që përcaktojnë se: *“Pas përfundimit të të gjitha procedurave të parapara me paragrafët e mësipërme të këtij neni, përgjigja përfundimtare e Komisionit procedohet për aprovim tek Ministri i ministrisë përgjegjëse për*

administratë publike dhe Ministri i ministrisë përgjegjëse për financa, të cilët aprovojnë klasifikimin e Komisionit në afat prej dhjetë (10) ditësh nga data e pranimit të përgjigjes. Në pajtim me paragrafin 9 të këtij neni, Ministri përgjegjës për administratë publike në bashkërendim me Ministrin përgjegjës për financa, së bashku me përgjigjen e Komisionit paraqet kërkesën për miratim përfundimtar në Qeveri dhe bën prezantimin përkatës”, procedura të cilat Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është dashur të ndjek me qëllim që pozita të cilën e kanë të lire si ministri apo e kanë të paraparë me organizmin e tyre të brendshëm duhet të jetë unike me sistemin qendror të përcaktuar si në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: “Ministria përgjegjëse krijon, mirëmban dhe administron regjistrin qendror të nëpunësve civil 2. Regjistri Qendror i Nëpunësve Civilë është sistem unik, që ndërvepron me bazën e të dhënave të sistemit të pagave, si dhe me bazën e të dhënave të sigurimit pensional të detyrueshëm” i përcaktuar edhe me nenin 9 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullores Nr.03/2010 për Përshkrimin e Detyrave të Punës si në vijim: “Udhëheqësi më i lartë administrativ ia dorëzon përshkrimin e punës DASHC/MAP së bashku me një organogram, i cili tregon vendosjen e pozitës përkatëse në kuadër të strukturës organizative të institucionit; DASHC/MAP shqyrton përshkrimin e punës për të konfirmuar nëse i plotëson standardet e përcaktuara me këtë rregullore, e vërteton nëse grada e propozuar është në përputhje me Rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës dhe e vërteton nëse pozita është e aprovuar nga aspekti buxhetor nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave”.

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit me datë 08.08.2019 e ka publikuar shpalljen e konkursit për pozitën “Zyrtar për Promovimin e Turizmit Kulturor” në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Gjakovë, me specifike të tjera nga ato të përcaktuara në Autorizimin e DASHC të datës 02.08.2019 veprim ky i cili është në kundërshtim me Autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil të datës 02.08.2019 dhe me këtë rast Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 16 paragrafi 1 nën paragrafët 1.2; 1.4 dhe 1.5 të cilët përcaktojnë se: “Shpallja e Rekrutimit përmban: 1.2 Titullin e vendit të punës dhe numrin e referencës; 1.4 përcaktimin e vendndodhjes së pozitës; 1.5 Përmbledhjen e shkurtër të përshkrimit të punës, në të cilin përshkruhet qëllimi i vendit të punës si dhe detyrat dhe përgjegjësit kryesore” si dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil të Kosovës neni 18 paragrafi 8 i cili përcakton se: “Procedurat e pranimit organizohen, menaxhohen dhe zbatohen nga institucioni, i cili ka për qëllim të plotësojë pozita të lira, në bashkëpunim dhe pajtueshmëri me departamentin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, i cili është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave të planifikimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në Shërbimin Civil të Kosovës” dhe mbi këtë bazë Kolegji ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara ndërsa procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të dispozitave ligjore për Shërbimin Civil si dhe të gjeturave të theksuara në pjesën e lartë cekur, ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Promovimin e Turizmit Kulturor” është zhvilluar në kundërshtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: “Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”, pasi që pozita që është shpallur për rekrutim jo që ka qenë e lirë, por s’ka qenë fare pjese e Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimi Civil, dhe mbi këtë bazë kjo procedurë e rekrutimit është anuluar me qëllim të kthimit të ligjshmërisë siç përcaktohet edhe me nenin 55 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “ Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës dhe Sportit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KZKA Nr:24/2019

të datës 30.09.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, dhe si i tillë Vendimi me numër KZKA Nr:24/2019 të datës 30.09.2019 është shfuqizuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda A.nr.182/2022

Flakron Gashi



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Arkivit të KPMSHCK-së